

20222463625

СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

L I G J

I MBËSHËTETJES FINANCIARE TË KATEGORIVE TË RREZIKUARA SOCIALE TË QYTETARËVE PËR PËRBALLIMIN E KRIZËS ENERGIJETIKE

Neni 1

Me këtë ligj përcaktohen shfrytëzuesit, kriteret, lartësia dhe mënyra për sigurimin e mbështetjes financiare të kategorive të rrezikuara sociale të qytetarëve për shkak të përballimit me krizën energjetike dhe të çmimeve.

Neni 2

Shfrytëzues të mbështetjes financiare, e cila sigurohet në përputhje me dispozitat e këtij ligji, për personat të cilët janë:

- shfrytëzues të së drejtës së sigurisë sociale të personave të moshuar;
- përfitues të shtesës së veçantë
- përfitues të së drejtës së kompensimit për shkak të aftësisë së kufizuar;
- persona me aftësi të kufizuar dhe ndryshime të përhershme në gjendjen shëndetësore, të cilët shfrytëzojnë kompensim për ndihmë dhe kujdes nga një person tjetër, dhe nuk shfrytëzojnë të drejtën e kompensimit për shkak të aftësisë së kufizuar, pa pasur nevojë për një ekzaminim kontrolli;
- prindër vetushqyes, shfrytëzues të ndihmës minimale të garantuar;
- shfrytëzues të së drejtës së pensionit në lartësi deri 14.000 denarë;
- shfrytëzues të së drejtës së kompensimit për dëmtim të lehtë dhe
- persona të papunësuar – shfrytëzues të së drejtës së sigurimit material në lloj të kompensimit monetar.

Neni 3

Disa shprehje të përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1) **“Shfrytëzues të së drejtës për sigurim social për të moshuarit”** janë personat mbi moshën 65 vjeçare të cilët në pajtim me Ligjin për sigurim social për personat e moshuar (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut numër 104/19), shfrytëzojnë të drejtën për siguri sociale dhe evidentohen në qendrat e punës sociale

2) **“Shfrytëzues të ndihmës së veçantë”** janë prindërit, kujdestarët ose personi të cilit i është besuar fëmija me vendim të qendrës kompetente për punë sociale dhe jeton në familje me të, ky është me aftësi të kufizuar deri në moshën 26 vjeçare në përputhje me Ligjin e Mbrojtjes së Fëmijëve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17, 21/18, 198/18 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 104/19, 146/19, 275/19, 311/20, 294/21 dhe 150/22).

3) **„Shfrytëzues të së drejtës së kompensimit për shkak të aftësisë së kufizuar“** janë personat mbi 26 vjeç dhe maksimumi deri në 65 vjeç, me aftësi të kufizuar intelektuale të rëndë ose të thellë, me aftësi të kufizuar fizike më të rëndë, një person që është krejtësisht i verbër dhe një person që është plotësisht i shurdhër.

4) **“Personat me aftësi të kufizuara dhe ndryshime të përhershme në gjendjen shëndetësore të cilët shfrytëzojnë kompensim për ndihmë dhe përkujdesje nga një person tjetër, pa pasur nevojë për ekzaminim kontrolli”** janë personat mbi 26 vjeç, me aftësi të kufizuar intelektuale të moderuar, të rëndë ose të thellë, me aftësi të kufizuar fizike më të rëndë

dhe shumë të rëndë dhe persona krejtësisht të verbër, me ndryshime të përhershme në gjendjen shëndetësore të përcaktuara nga konstatimi, vlerësimi dhe mendimi për nevojën për ndihmë dhe kujdes nga një person tjetër, të miratuar nga komisioni profesional pa pasur nevojë për ekzaminim kontrolli, të cilët kanë nevojë për ndihmë dhe kujdes nga një person tjetër, për faktin se nuk mund të kryejnë vetëm aktivitetet themelore të jetës së përditshme dhe nuk e shfrytëzojnë të drejtën e kompensimit për shkak të aftësisë së kufizuar.

5) **“Prindër vetushqyes, që janë evidentuar shfrytëzues të ndihmës së garantuar minimale”** janë prindër që janë shfrytëzues të ndihmës së garantuar minimale të evidentuar në Qendrat për punë sociale të cilët vetë i kryejnë është prindi që ushtron i vetëm të drejtat dhe detyrat prindërore për fëmijën, për faktin se prindi tjetër është i panjohur, i vdekur, i zhdukur ose për arsye të justifikuara nuk ushtron përkohësisht ose përgjithmonë të drejtat dhe detyrat prindërore, deri në fillimin e shkollimit fillor të fëmijës, por jo më vonë se moshë shtatëvjeçare e fëmijës dhe deri në fëmijën e tretë.

6) **“Shfrytëzues të pensionit”** janë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilët janë shfrytëzues të pensionit të pavarur ose pjesë proporcionale të pensionit të realizuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe jetojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të cilët përfundimisht me muajin e hyrjes në fuqi të këtij ligji kanë realizuar të hyra në bazë të pensionit në shumë prej jo më të madhe se 11.525 denarë në muaj, përkatësisht në shumë jo më shumë se 14.000 denarë në muaj, sipas të dhënave nga evidencat e Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut;

7) **“Shfrytëzues të së drejtës për kompensim të dëmit fizik”** janë personat të cilët e shfrytëzojnë këtë të drejtë në pajtim me Ligjin për Sigurim Pensional dhe Invalidor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 98/12, 166/12, 15/13, 170/13, 43/14, 44/14, 97/14, 113/14, 160/14, 188/14, 20/15, 61/15, 97/15, 129/15, 147/15, 154/15, 173/15, 217/15, 27/16, 120/16, 132/16, 35/18, 220/18, 245/18 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 180/19, 245/19, 31/20, 267/20 dhe 67/22);

8) **“Personat e papunësuar – shfrytëzues të së drejtës për sigurim material në formë të kompensimi monetar”**, janë personat që e shfrytëzojnë këtë të drejtë në përputhje me Ligjin për sigurimin material të personave të papunë për shkak të privatizimit të ndërmarrjeve me pronësi dominuese të shtetit në periudhën nga viti 2000 deri në vitin 2004 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 87/2008 dhe 33/14), Ligji për sigurimin material të personave të papunë për shkak të privatizimit të ndërmarrjeve me pronësi dominuese të shtetit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 132/17 dhe 51/18), Ligji për sigurimin material të personave të papunë për shkak të privatizimit të ndërmarrjeve me pronësi dominuese të shtetit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 198/18 dhe 241/18), Ligji për sigurimin material të personave të papunë për shkak të privatizimit të ndërmarrjeve me pronësi dominuese të shtetit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 10/20) dhe Ligji i Sigurisë Materiale të Personave të Papunë për shkak të Privatizimit të Ndërmarrjeve me Pronësi Dominuese të Shtetit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 174/21).

Neni 4

Mbështetja financiare për shfrytëzuesit e ndihmës financiare, sipas nenit 2, paragrafi (1), nënparagrafët 1, 2, 3, 4 dhe 5 të këtij ligji, është 3.000 denarë në muaj, në kohëzgjatje prej katër muajsh, duke filluar nga muaji i ardhshëm, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(1) Mbështetja financiare për personat, sipas nenit 2 paragrafi (1), nënparagrafi (6) të këtij ligji, të cilët kanë realizuar të ardhura në bazë të pensionit në shumë jo më të madhe se 11.525 denarë në muaj arrin 1.500 denarë në muaj, për një periudhë prej katër muajsh, duke filluar nga muaji i ardhshëm nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Mbështetja financiare për shfrytëzuesit që kanë realizuar të ardhura në bazë të pensionit prej 11.526 denarë deri në 14.000 denarë në muaj, është 750 denarë në muaj, për një periudhë prej katër muajsh, duke filluar nga muaji i ardhshëm, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji

(2) Mbështetja financiare për personat, sipas nenit 2, paragrafi (1), nënparagrafi 7 të këtij ligji, është 750 denarë në muaj, në kohëzgjatje prej katër muajsh, duke filluar nga muaji i ardhshëm, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji

(3) Mbështetja financiare për personat, sipas nenit 2, paragrafi (1), nënparagrafi 8 të këtij ligji, është 3.000 denarë në muaj, në kohëzgjatje prej katër muajsh duke filluar nga muaji i ardhshëm, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(4) Shuma e të ardhurave mujore të realizuara në bazë të pensionit nga paragrafi (2) të këtij neni për shfrytëzuesit e pjesës proporcionale të pensionit të realizuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, caktohet me mbledhjen e pjesës proporcionale të pensionit të realizuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe pjesës proporcionale nga pensioni i realizuar në shtetin e huaj në përputhje me marrëveshje ndërkombëtare.

Neni 5

(1) Mjetet për mbështetjen financiare në shumën dhe në periudhën e përcaktuar në nenin 4 të këtij ligji, paguhet në shumën monetare në llogarinë bankare të shfrytëzuesit të mbështetjes financiare, siç vijon:

- për shfrytëzuesit, sipas nenit 2, paragrafi (1), nënparagrafët 1, 2, 3, 4 dhe 5 të këtij ligji, nga Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale, sipas të dhënave nga evidenca e qendrave të punës sociale;

- për shfrytëzuesit, sipas nenit 2, paragrafi (1), nënparagrafët 6 dhe 7 të këtij ligji, nga Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë së Veriut, sipas të dhënave nga evidenca e Fondit;

- për shfrytëzuesit, sipas nenit 2, paragrafi (1), nënparagrafi 8, nga Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut, sipas të dhënave nga evidenca e saj.

(2) Pagesa e mbështetjes financiare për shfrytëzuesit, sipas nenit 2 të këtij ligji, bëhet pa parashtruar kërkesë nga shfrytëzuesit, në bazë të listave të shfrytëzuesve për mbështetje financiare, përpiluar në bazë të të dhënave nga evidenca e institucioneve, sipas paragrafit 1 të këtij neni.

(3) Në ueb-faqen e Ministrisë së Punës dhe të Politikës Sociale, Fondit i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë së Veriut dhe Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, publikohen listat e shfrytëzuesve të mbështetjes financiare më së voni deri më datë 5 të muajit dhe data kur do të kryhet pagesa e mbështetjes financiare.

(5) Listat, sipas paragrafit (3) të këtij neni, përmbajnë emrin dhe mbiemrin e shfrytëzuesit të mbështetjes financiare dhe adresën e vendbanimit të tij;

(6) Grumbullimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave të dorëzuara për shkak të përgatitjes së listave, sipas paragrafit (3) të këtij neni, kryhet në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 6

(1) Ministri i Punës dhe i Politikës Sociale themelon komisionin për vendimmarrje për kundërshtimet ndaj mbështetjes financiare të përbërë nga nëntë anëtarë, nga të punësuarit, pra nga tre anëtarë nga Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale, një anëtar nga Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut, dy anëtarë nga qendrat e punës sociale dhe tre anëtarë nga Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut.

(2) Shfrytëzuesi, i cili është në listë, sipas nenit 5, paragrafi (3), të këtij ligji, dhe i cili konsideron se i plotëson kushtet si shfrytëzues i së drejtës, sipas nenit 2 të këtij ligji, mund të parashtrorë kundërshtim drejtuar Komisionit të vendimmarrjes për kundërshtimet ndaj mbështetjes financiare, në afat prej tri ditësh nga data e publikimit të listave të shfrytëzuesve të mbështetjes financiare, sipas nenit 5, paragrafi (1) të këtij ligji.

(3) Komisioni, sipas paragrafit (1) të këtij neni, pas kundërshtimeve të parashtruara vendos në afat prej 15 ditësh nga parashtrimi i kundërshtimit.

(4) Komisioni për kundërshtimet e miratuara dorëzon njoftim te parashtruesi dhe tek institucionet, sipas nenit 5, paragrafi (1) të këtij ligji, ndërkaq për ato që janë refuzuar, te parashtruesi.

Neni 7

Mbështetja financiare e pranuar, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, nuk tatimohet mbi të ardhurat personale në pajtim me Ligjin e Tatimit mbi të Ardhurat Personale.

Neni 8

(1) Mbështetja financiare do t'u paguhet shfrytëzuesve të të drejtave, sipas nenit 2 të këtij ligji, duke filluar nga muaji i ardhshëm pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, për një periudhë prej katër muajsh radhazi.

(2) Mbështetja financiare do t'u paguhet edhe shfrytëzuesve të cilët do të fitojnë të drejtën, sipas nenit 2 të këtij ligji, gjatë kohëzgjatjes së periudhës së mbështetjes financiare, kurse pagesa do të kryhet për periudhën e mbetur të mbështetjes financiare nga dita fitimit të së drejtës.

(3) Mbështetja financiare për shfrytëzuesit nga neni 4 paragrafi (2) i këtij ligji pushon së paguari ose shuma e saj ndryshohet në rast të rritjes së shumës së të ardhurave mujore në bazë të pensionit gjatë kohëzgjatjes së periudhës së mbështetjes financiare.

Neni 9

Mbikëqyrjen mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji e kryen Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.